U D H Ë Z I M
Nr. 2220, datë 18.7.2001

PËR LICENCIMIN E SUBJEKTEVE SHTETËRORË DHE PRIVATE QË KRYEJNË SHERBIMIN E TELEKOMUNIKACIONEVE NË NDIHMË TË NAVIGIMIT AJROR DHE KONTROLLIT TË TRAFIKUT AJROR

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, dekretit nr. 7438 datë 1.12.1990 " Për aderimin e Republikës të Shqipërisë në Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar" nenit 37 dhe Aneksit 10 i saj, ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 " Për saksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës të lirë, të veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit", ndryshuar me ligjin nr. 7723, datë 21.6.1993 " Për një shtesë në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991", ligjit nr 7877, datë 30.11.1994 "Për Aviacionin Civil Shqiptar", nenin 77 , Ministri Transportit

U D H Ë Z O N:

Kapitulli I – E përgjithshme

1.1 Fusha e Aplikimit

Ky kapitull përshkruan rregullat që zbatohen për:

(1) licencimin dhe operimin e subjekteve që sigurojnë shërbimin e telekomunikacioneve aeronautike, në mbështetje të fluturimeve IFR-së ose në mbështetje të një shërbimi të trafikut ajror;

(2) standardet e operimit dhe teknike për fasilitetet që përdoren nga këto subjekte.

1.2 Përkufizime

Në këtë udhëzim, me termat e mëposhtme do të nënkuptojmë:

Shërbimi i Telekomunikacioneve Aeronautik:

(1) një shërbim telekomunikacioni i ngritur për të mbështetur shërbimet që vijojnë, siç përcaktohen në Aneksin 10, volumi II, kapitulli 1:

(i) shërbimi i difuzionit (radiopërhapjes) aeronautik;

(ii) shërbimi fiks aeronautik;

(iii) shërbimi i lëvizshëm aeronautik;

(iv) shërbimi i navigimit aeronautik me radio;

(2) çdo shërbim tjetër telekomunikacioni i ngritur specifikisht për të mbështetur sistemin e navigimit ajror shqiptar:

Aneksi 10 - Aneksi 10 i Konventës së ICAO-s, duke përfshirë të gjitha amendamentet përkatëse.

Parametër kritik: Një parametër i cili ka efekte të drejtpërdrejta në integritetin operacional të një fasiliteti.

DPAC: Drejtoria e Përgjithshme të Aviacionit Civil

Fasiliteti:

(1) tipet që vijojnë të sistemeve të komunikimit që përdoren për shërbimin e difuzionit aeronautik (siç ky shërbim përcaktohet në Aneksin 10, volumi II, kapitulli 1); për dhënien e informacionit meteorologjik për avionin në fluturim (VOLMET); për dhënien e informacionit për terminalin (ATIS);

(2) tipet që vijojnë të sistemeve të komunikimit, të përdorura për shërbimin fiks aeronautik (siç përcaktohet në Aneksin 10 të ICAO-s, vol II, kapitulli 1): Qarqet zanore të dedikuara të ATS-së: Rrjeti fiks i telekomunikacioneve aeronautike (AFTN): Shkëmbimi i të dhënave tokë-tokë:

(3) elementet tokësore të tipeve të mëposhtme të sistemeve komunikimit që sigurojnë shërbimin aeronautik të lëvizshëm (siç shërbimi përcaktohet në Aneksin 10, volumi II, kapitulli 1):

komunikimet HF ajër-tokë,

komunikimet VHF ajër-tokë,

komunikimet UHF ajër-tokë

sistemet e thirrjes selective (SELCAL):

shkëmbimi i të dhënave ajër-tokë.

(4) Tipet e mëposhtme të pajisjeve ndihmëse radio-navigacionale, në mbështetje të shërbimit të navigimit aeronautik me radio (ashtu si ky shërbim përcaktohet ne Aneksin 10, volumi II, kapitulli

1):

- sistemi i uljes me instrumenta (ILS),
- sistemi i uljes me mikrovale (MLS),
- radio shumëdrejtimëshe VHF (VOR),
- paisja e Matjes të Distancës (DME),
- pajisja radio jodrejtimëshe (prurësi) (NDB),
- radari i afrimit me precision (PAR),
- radari sekondar i mbikëqyrës,
- radari primar i mbikëqyrjes:

(5) tipet e mëposhtme të sistemeve të telekomunikacionit që mbështesin një shërbim të trafikut ajror:

- sistemi i përpunimit të të dhënave të fluturimit (FDPS),
- sistemi i përpunimit të të dhënave të radarit (RDPS),
- sistemi i përpunimit të të dhënave të radarit dhe të fluturimit (RFDPS).

1.3 Kërkesat për lëshimin e licencës

(a) Më përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin (c), asnjë subjekt nuk duhet të sigurojë një shërbim telekomunikacioni aeronautik ose të operojë një fasilitet me perjashtim kur është i licencuar nga DPAC-ja dhe në përputhje me kushtet e licencës.

(b) DPAC-ja mund të lëshojë një licencë, duke autorizuar shërbimin e telekomunikacioneve aeronautike që variojnë nga operimi i nje fasiliteti të vetmuar, deri tek nje rrjet fasilitetesh të kërkuara për sistemin e navigimit ajror shqiptar.

e) Një subjekt mund të operojë një fasilitet në një frekuencë të brezit aeronautik të radios, pa pasur një licencë nëse:

(1) fasiliteti:

(i) është një fasilitet radio-komunikimi që nuk mbështet një shërbim trafiku ajror;

(ii) është nje pajisje ndihmëse radio - navigacionale që nuk mbështet fluturime IFR ose një shërbim trafiku ajror;

(2) fasiliteti nuk krijon interferencë me ndonjë shërbim apo fasilitet tjetër aeronautik; dhe ku është e aplikueshme;

(i) Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ka lëshuar një licencë për përdorim si radio për fasilitetin;

(ii) DPAC-ja ka përcaktuar një kod identifikimi ose shenjë thirrje për fasilitetin.

1.4 Aplikimi për licencë

Çdo subjekt për marrjen e një licence shërbimi të telekomunikacioneve duhet të plotësojë formularin tip dhe ta dorëzojë në DPAC, duke përfshirë dhe:

(1) ekspozimin e kërkuar nga paragrafi 2.13;

(2) pagesën e tarifës përkatëse të aplikimit, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave.

1.5 Lëshimi i licencës

Një subjekt ka të drejtën e marrjes të një licence të shërbimit të telekomunikacioneve nëse DPAC-ja është e bindur që:

(1) subjekti përmbush kërkesat e kapitullit II;

(2) subjekti dhe personat ose personi drejtues i kërkuar nga paragrafi 2.1 (a) (1) dhe (2) janë persona të përshtatshëm;

(3) lëshimi i licencës nuk është në kundërshtim me interesat e sigurisë në aviacion.

1.6 Privilegjet e mbajtësit të licencës

(a) Licenca e shërbimit të telekomunikacioneve specifikon tipat e fasiliteteve që mbajtësi i licencës është i autorizuar të operojë.

(b) Subjekt i paragrafit 3.7, mbajtësi i licencës të shërbimit të telekomunikacioneve mund të operojë çdo tip fasiliteti të përfshirë në listen e licencës duke siguruar që:

(1) fasiliteti që operon është në listën e licencës; ose

(2) nëse fasiliteti nuk është përfshirë ne listën e licencës, operimi i tij është vetëm për qëllime testimi të vendit të mundshëm të instalimit.

1.7 Kohëzgjatja e vlefshmërisë të licencës

(a) Licenca e shërbimit te telekomunikacioneve mund të lëshohet ose rinovohet për një

periudhë nga 1 deri në 5 vjet.

(b) Licenca e shërbimit të telekomunikacioneve qëndron në fuqi deri sa mbaron afati i vlefshmerisë, është pezulluar ose anuluar.

1.8 Rinovimi i licencës

(a) Aplikimi për rinovimin e licencës të shërbimit të telekomunikacioneve duhet të bëhet sipas formularit tip.

(b) Aplikimi duhet të dorëzohet në DPAC , jo më pak se 30 ditë përpara kohës të skadimit të licencës.

1.9 Përjashtimet

Për shkelje të normave të këtij udhëzimi, DPAC-ja mund të marrë masa përkatëse që shkojnë deri në revokimin e licencës së lëshuar.

Kapitulli II – Kërkesat për licencimin

2.1 Kërkesat e personelit

(a) Çdo subjekt për për të marrë një licencë shërbimi telekomunikacionesh aeronautike duhet të angazhojë, punësojë dhe të lidhë kontratë me:

(1) një person drejtues i identifikuar si Drejtori Ekzekutiv, i cili ka autoritetin brenda subjektit të sigurojë që aktivitetet e realizuara nga subjekti mund të financohen dhe të realizohen për të përmbushur kërkesat operacionale dhe në përputhje me kërkesat e përshkruara nga ky udhëzim;

(2) një person drejtues ose një grup personash drejtues, të cilët janë përgjegjës për të siguruar që subjekti vepron në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi; Ky ose këta persona të ëmëruar do të jenë drejtpërdrejt përgjegjës kundrejt Drejtorit Ekzekutiv.

(3) personel të mjaftueshëm për të inspektuar, mbikqyrur dhe mirëmbajtur fasilitetet e përfshira në listën e ekspozimit të subjektit.

(b) Subjekti duhet:

(1) të hartojë një procedurë për vlerësimin e aftësive të personelit të autorizuar prej tij për të vënë në punë ndonjë nga fasilitetet e përfshira në listën e ekspozimit;

(2) të hartojë një procedure për të ruajtur aftësitë profesionale të personelit të autorizuar;

(3) t'i sigurojë personelit të autorizuar dokument me shkrim mbi fushën për të cilën ata janë të autorizuar.

2.2 Kërkesat për fasilitetet

(a) çdo subjekt për të marrë një licencë shërbimi telekomunikacionesh duhet të hartojë procedura për të siguruar që:

(1) çdo fasilitet i përfshirë në listën e ekspozimit të tij:

(i) është projektuar, instaluar dhe vënë në punë, duke përmbushur specifikimet e aplikueshme operacionale;

(ii) është në përputhje me karakteristikat e aplikueshme të sistemit dhe standardet e specifikuara të sistemit të përshkruara në vol I të aneksit 10;

(2) çdo pajisje NDB e përfshirë në listën e ekspozimit është në përputhje me kërkesat e mëposhtme (të cilat janë shtesë e specifikimeve të përshkruara në seksionin 3.4 të Aneksit 10, volumi I, pjesa I);

(i) sinjali i rrezatuar duhet të jetë një bartëse e pandërprerë e moduluar me ndërprerje me një sinjal audio 1020Hz plus/minus 50Hz ose me një bartëse e dytë me zhvendosje me 1020Hz +/- 50Hz nga bartësja e vazhdueshme.

(ii) funksionet monitorizuese të rekomanduara në paragrafët 3.4.8.2 dhe 3.4.8.4 të Aneksit 10, volumi I, pjesa I duhet të interpretohen, si kërkesa të detyrueshme për çdo NDB:

(iii) sistemi i monitorimit për çdo fasilitet NDB duhet të transmetojë një tërheqje vëmendje në një post kontrolli dhe të shkëpusë nga operimi NDB në rast se zbulon ndonjë nga situatat e detajuara në paragrafët 3.4.8.1 dhe 3.4.8.2 të Aneksit 10, volumi I, pjesa I;

(3) çdo pajisje UHF e matjes së distancës (DME), e përfshirë në listën e ekspozimit është në përputhje me kërkesat e mëposhtme (të cilat janë si shtojcë ë specifikimeve të përshkruara në seksionin 3.5 te Aneksit 10,volumi I, pjesa I):

(i) sinjali i kodit të identifikimit të NDB-së, i përshkruar në paragrafin 3.5.3.6.3(a) të Aneksit 10,volumi I, pjesa I, duhet të transmetohet të paktën një herë, por jo më shumë se dy herë çdo 40 sekonda me grupet e kodit të ndara me hapësire të barabarta;

(ii) funksionet e monitorimit të rekomanduara në paragrafin 3.5.4.7.2.3. të Aneksit 10, volumi

I, pjesa I duhet të interpretohen si një kërkesë specifike e detyrueshme për çdo fasilitet DME; dhe

(2) çdo pajisje radio-navigacionale, e përfshirë në listën je ekspozimit, është pajisur me një sistem monitorimi që do të shkëpusë pajisjen nga operimi dhe do të transmetojë një tërheqje vëmendjeje në një post kontrolli mbas ndodhjes të ndonjë nga situatat e mëposhtme:

(i) të dhënat navigacionale jashtë tolerancës të përshkruar të fasilitetit;

(ii) mostransmetim i sinjalit të identifikimit;

(iii) defekt i sistemit të monitorimit;

(5) Informacioni mbi gjendjen operacionale të çdo pajisje radio-navigacionale, e përfshirë në listën e ekspozimit dhe që është thelbësore për zonën e afrimit, uljen dhe ngritjen në një aerodrom duhet t'i sigurohet pa vonesë:

(i) kullës të kontrollit nëse aerodromi e ka një të tillë;

(ii) njësisë të kontrollit të trafikut ajror që siguron një shërbim kontrolli të zonës të afrimit për atë aerodrom nëse një shërbim i tillë ekziston;

(6) çdo fasilitet i përfshirë në listën e ekspozimit, është instaluar me burime ushqimi të përshtatshëm dhe mjete për të siguruar vazhdushmërinë e përshtatshme të operimit, në përputhje me nevojat e shërbimit operacional që ky fasilitet mbështet;

(7) çdo fasilitet i përfshirë në listën e ekspozimit është instaluar në përputhje me programin e sigurisë të rrugëve ajrore të kërkuar nga paragrafi 2.3, me qëllim minimizimin e rrezikut të shkatërrimit, dëmtimit ose interferencës në operimin e fasilitetit;

(8) çdo zonë kritike e çdo fasiliteti të përfshirë në listën e tyre të ekspozimit është:

(i) identifikuar saktësisht në skicën e vendodhjes të fasilitetit;

(ii) e mbrojtur fizikisht prej shenjave të përshtatshme në vendin e instalimit;

(iii) e mbrojtur nga marrëveshje me shkrim me pronarin e tokës, operuesin e aerodromit ose njësinë e kontrollit të trafikut ajror, për t'u siguruar që kërkesat teknike për vendin e instalimit nuk janë cënuar nga ndërtesat, gardhet, makinat, makineritë ose vetë avionët.

(b) Atje ku subjekti ka qëllim të vere në operim të përkohshëm një fasilitet me qëllim bërjen e një testimi të vendit të instalimit, ai duhet të hartojë një procedure për bërjen e këtyre testimeve. Procedura duhet të sigurojë që nuk do të ketë interferenca të mundshme mbi ndonjë pajisje tjetër të afërt në operim dhe që informacioni i nevojshëm do t'i sigurohet Shërbimit të Informacionit Aeronautik (AIS) për lëshimin e një NOTAM-i ose publikimin e një shtojce (Supplement) në AIP.

2.3 Programi i Sigurisë të Rrugëve Ajrore

Çdo subjekt për marrjen e një licence të telekomunikacioneve aeronautike është i detyruar të hartojë një program të sigurisë të rrugëve ajrore për fasilitetet e përfshira në listën e ekspozuar të tij.

2.4 Dokumentacioni

(a) Çdo subjekt duhet të ruajë kopje të manualeve përkatës të pajisjes, të standardeve dhe praktikave teknike përkatëse (përfshirë dhe Aneksin 10) dhe ndonjë dokument tjetër (përfshirë instruksionet teknike) që janë të nevojshme për vënien në punë dhe operimin e fasiliteteve të përfshira në listën e ekspozimit.

(b) Subjekti duhet të hartojë procedurën për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në paragrafin (a). Procedura duhet të sigurojë që:

(1) i gjithë dokumentacioni është rishikuar dhe autorizuar për përdorim nga personel i kualifikuar;

(2) botimet më të fundit të të gjithë dokumenteve përkatëse i janë dhënë në dispozicionit personelit kur ata kanë nevojë ta shfrytëzojnë dokumentacionin për vënien në punë dhe operimin e fasilitetit;

(3) i gjithë dokumentacioni i vjetëruar është larguar nga qarkullimi dhe përdorimi;

(4) ndryshimet në dokumentacion janë rishikuar dhe aprovuar nga personel i kualifikuar;

(5) botimi i fundit i çdo elementi të dokumentacionit të mund të identifikohet me qëllim përjashtimin e botimeve të vjetëruara.

2.5 Inspektimi dhe testimi periodik

(a) Subjekti duhet të hartojë një procedurë për inspektimet dhe testimet periodike të fasiliteteve te përfshira në listën e ekspozimit me qëllim verifikimin e përmbushjes të kërkesave operacionale dhe specifikimeve teknike.

(b) Kjo procedurë duhet:

(1) të mbulojë inspektimet dhe testimet në tokë dhe ku është e nevojshme testimet në

fluturim;

(2) të përfshijë kriteret për vendosjen ose ndryshimin e periudhës kohore ndërmjet testimeve periodike për një fasilitet. Kriteret duhet të kenë parasysh:

(i) çdo informacion të aplikueshëm të publikuar nga ICAO-ja ose ndonjë autoritet tjetër aeronautik,

(ii) çdo të dhënë të besushme të aplikueshme për fasilitetin;

(iii)çdo informacion mbi parametrat e besueshme të provuara të fasilitetit, parametrat e provuara të fasilteteve të tjera të ngjashme dhe stabilitetin e ambjentit në të cilin operon fasiliteti;

(3) të sigurojë që kriteret për vendosjen ose ndryshimin e periudhës kohore ndërmjet testimeve periodike për fasilitetin janë të dokumentuara.

(c) Si shtojcë, subjekti duhet të hartojë:

(1) një program të inspektimeve periodike në tokë për çdo fasilitet;

(2) një program të testimeve periodike në tokë për çdo fasilitet;

(3) një program të testimeve periodike në fluturim për çdo pajisje radio-navigacionale. Ky program mund të mos bëhet vetëm nëse subjekti mund të sigurojë që me kriteret e përshkruara në paragrafin (b) (2), testimet periodike në tokë mund të zëvendësojnë testimet periodike në fluturim për një pajisje, pa prekur sigurinë në navigimin ajror.

d) Programet e kërkuara nga paragrafi (c) (2) dhe (3) për testimet periodike në fluturim dhe në tokë duhet të bazohen në kriteret e paragrafit (b) (2) dhe duhet të specifikojnë periudhën kohore maksimale ndërmjet dy testimeve për çdo fasilitet.

e) Subjekti duhet të njoftojë DPAC-në për çdo pajisje radio-navigacionale që nuk është subjekt i testimeve periodike në fluturim.

2.6 Licencimi i parametrave të fasilitetit

Çdo subjekt për licencë të shërbimit të telekomunikacioneve duhet të hartojë një procedurë për të siguruar që çdo fasilitet që ndodhet në listën e ekspozimit të tij do të vihet në operim, vetëm nëse:

(1) personi që vë në operim pajisjen është autorizuar dhe vlerësuar si kompetent në përputhje me procedurat e kërkuara nga paragrafin 2.1 (b);

(2) kontrolle të përshtatshme janë kryer për të verifikuar parametrat e fasilitetit;

(3) rregjistrimi mbi gjendjen e fasilitetit është kompletuar, në përputhje me procedura e kerkuar nga paragrafi 2.1.

2.7 Inspektimi i pajisjeve të matjes dhe testimit

(a) Çdo subjekt për licence të shërbimit të telekomunikacioneve duhet të sigurojë që pajisje të përshtatshme matëse dhe testimi janë në dispozicion të personelit për të mbajtur një operim të sigurt të çdo fasiliteti të paraqitur në listën e ekspozimit të tij.

(b) Subjekti duhet të hartojë një procedure për kontrollin, kalibrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të inspektimit, matjes dhe testimit për të siguruar që çdo element i pajisjes ka precizionin dhe saktësinë e nevojshme për matjen dhe testimin që do të kryejë.

(c) Procedura duhet të sigurojë që çdo element i pajisjes të testimit, kërkuar për matjen e parametrave kritikë është:

(1) kalibruar përpara përdorimit ose kalibruar në intervale të përcaktuara kundrejt një pajisjeje të certifikuar kundrejt standardeve nacionale. Atje ku nuk ekziston një standard i tillë, referenca e përdorur për kalibrim duhet dokumentuar. Rregjistrimi i kalibrimeve dhe standardeve të përdorura duhet mirëmbajtur, në përputhje me procedurat e kërkuara nga paragrafi 2.11;

(2) identifikuar me një tregues të përshtatshëm për të ekspozuar gjendjen e tij të kalibrimit;

(3) kontrolluar për:

(i) ta ruajtur ndaj ndërhyrjeve që do të bëjnë të pavlefshme parametrat e kalibrimit;

(ii) t'u siguruar që dorëzimi, ruajtja dhe mbajtja në magazinë është në kushte të tilla që saktësia dhe besueshmëria për përdorim është ruajtur.

(d) Atje ku sistemet “hardware” dhe “software” janë përdorur si një formë alternative e testimit të parametrave të fasilitetit, funksionet e sistemeve duhet të kontrollohen përpara se të jepen për përdorim, me qëllim që te sigurohet që ata janë të aftë të verifikojnë parametrat e fasilitetit. Këto funksione duhet të kontrollohen në intervale të paracaktuara. Rregjistrimi i këtyre kontrolleve duhet të ruhet si evidentim dhe verifikim i parametrave të përshtatshme të sistemit të testimit.

2.8 Njoftimi mbi fasilitetin

(a) Çdo subjekt për të marrë një licencë të shërbimit të telekomunikacioneve duhet të hartojë një procedure për të njoftuar përdoruesit e pajisjeve të përfshira në listën e ekspozimit për gjendjen operacionale të çdo fasiliteti dhe çdo ndryshim të gjendjes.

(b) Procedura duhet të sigurojë që:

(1) informacioni mbi gjendjen operacionale të çdo fasiliteti që përdoret në shërbimin e trafikut ajror ose sistemin e navigimit ajror i është dhënë Shërbimit të Informacionit Aeronautik (AIS) për publikim në AIP;

(2) përdoruesit e fasilitetit janë njoftuar pa vonesë për çdo ndryshim në gjendjen operacionale të fasilitetit, nëse ndryshimi mund të cenojë sigurinë në navigimin ajror. Për ato fasilite të publikuara në AIP informacioni i lidhur me çdo ndryshim të gjendjes të tyre operacionale duhet t'i jepet shërbimit AIS për nxjerrjen e një NOTAM-i.

2.9 Kontrolli i fasilitetit pas incidentit ose aksidentit

(a) Çdo subjekt, për të marrë një licencë shërbimi telekomunikacionesh, duhet të hartojë një procedurë për të kontrolluar dhe rregjistruar konditat e operimit të çdo fasiliteti, të përfshirë në listën e tij të ekspozimit që mund të ketë qenë përdorur nga një avion ose një shërbim trafiku ajror i përfshirë në një aksident ose incident.

(b) Procedura duhet të sigurojë që:

(1) kontrollet janë bërë sa më shpejt të jetë e mundur mbas njoftimit të subjektit për një aksident ose incident të tillë;

(2) rregjistrimi i gjendjes të operimit të pajisjes gjatë kontrollit, si dhe historia e kaluar e pajisjes është ruajtur në një vend të sigurt për përdorim të mundshëm në rast investigimi të mëvonshëm.

2.10 Operimi defektoz i pajisjes

(a) Çdo subjekt, për të marrë një licencë të shërbimit të telekomunikacioneve duhet të hartojë një procedure për të regjistruar, investiguar, dhe riparuar çdo difekt të zbuluar ose të raportuar çdo pajisje të përfshirë në listën e ekspozimit te tij.

(b) Procedura duhet të sigurojë që një raport i është përcjellë DPAC kurdoherë që një investigim për operimin difektoz të pajisjes zbulon që:

(1) pajisja ka qënë në operim jashtë tolerancave të lejueshme;

(2) fasiliteti ka pasur kushte për të operuar potencialisht jashtë tolerancave të lejueshme.

(c) Raporti i kërkuar në paragrafin (b) duhet të dorëzohet brenda 10 ditësh, pasi operimi difektoz është zbuluar ose raportuar dhe duhet të përfshijë detaje të plota të keqfunksionimit, konkluzionet e investigimit dhe masat e marra për të ndaluar përsëritjen.

2.11. Rregjistrimet

(a) Çdo subjekt, për marrjen e një licence shërbimi telekomunikacionesh, duhet të hartojë procedurat për të identifikuar, mbledhur, indeksuar, ruajtur, mirëmbajtur dhe shfrytëzuar rregjistrimet që janë të nevojshme për operimin e sigurtë të fasiliteteve të përfshira në listën e ekspozimit.

(b) Procedurat duhet të sigurojnë që:

(1) një rregjistrim është mbajtur për çdo fasilitet me qëllim që:

(i) të dokumentohen parametrat e fasilitetit;

(ii) të sigurohet historia e tij e mirëmbajtjes, inspektimeve dhe testimeve periodike;

(2) është siguruar një rregjistrim për dokumentacionin e kërkuar nga paragrafi 2.5 (b) (3) në lidhje me vendosjen e, ose ndryshimin në, testimeve periodike të fasilitetit;

(3) ekziston një rregjistrim për çdo element të pajisjes të testimit e kërkuar për matjen e parametrave kritike të pajisjes. Rregjistrimi duhet të sigurojë një histori të saktë të vendit, mirëmbajtjes dhe kontrolleve të kalibrimit të pajisjeve të tilla të testimit;

(4) ka një rregjistrim të çdo funksionimi difektoz të pajisjes e rregjistruar dhe e investiguar në përputhje me procedurat e kërkuara nga paragrafi 2.10 (a). Rregjistrimi duhet të detajojë natyrën e keqfunksionimit, përfundimet e investigimit, veprimet e ndërmarra për rregullim ose ku është e aplikueshme të përfshihet dhe një kopje e raportit dërguar DPAC-së;

(5) ka një rregjistrim për çdo rishikim të kontrollit të brendshëm të cilësisë të subjektit të aplikantit të realizuar në përputhje me procedurat e kërkuara nga paragrafi 2.12 (a);

(6) ka një rregjistrim për çdo person, i cili është i autorizuar nga subjekti për të vendosur fasilitetin në gjendje operimi. Rregjistrimi duhet të përfshijë eksperiencën e tij, kualifikimin, trajnimin, vlerësimin e kopetencës dhe autorizimin;

(7) të gjitha rregjistrimet janë të lexueshme dhe me një natyrë të përhershme;

(8) të gjitha rregjistrimet e fasilitetit janë ruajtur për një periudhë të paktën 3-vjeçare, në mos po një periudhë më e gjatë është kërkuar për të pasur një histori të gjendjes të parametrave të fasilitetit

2.12 Kontrolli i brendshëm i cilësisë

(a) Çdo subjekt, për të marrë një licencë shërbimi telekomunikacionesh, duhet të hartojë procedura kontrolli të brendshëm të cilësisë për të siguruar përputhjen me procedurat dhe programet e kërkuara nga ky udhëzim.

(b) Personi përgjegjës, i cili ka përgjegjësinë për kontrollin e brendshëm të cilësisë duhet të ketë kontakte të drejpërdrejta me Drejtorin Ekzekutiv të subjektit për problemet, që cenojnë parametrat e fasiliteteve.

2.13 Ekspozimi i organizimit

(a) Çdo subjekt, për të marrë një licencë shërbimi telekomunikacionesh, duhet t'i prezantojë DPAC-së një ekspozim, i cili të përfshijë:

(1) një deklaratë të nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv në emër të subjektit, ku të konfirmohet se ekspozimi dhe çdo manual i përfshirë:

(i) përcakton subjektin dhe demonstron mjetet dhe metodat që do përdoren për të siguruar përputhjen në vazhdimësi me këtë udhëzim;

(ii) do të jetë në përputhje me të në çdo kohë;

(2) titujt dhe emrat e personit ose personave drejtues të kërkuara nga paragrafi 2.1 (a) (1) dhe (2);

(3) detyrat dhe përgjegjësitë e personit ose personave drejtues, të specifikuar në paragrafin (a), (2), duke përfshirë çështjet për të cilat ata kanë përgjegjësinë për të pasur kontakte të drejtpërdrejta me Drejtorin ose DPAC-në në emër të subjektit; dhe

(4) një skemë organizimi e subjektit që tregon linjat e përgjegjësise të personave përgjegjës të specifikuar në paragrafin (a) (2) dhe e shtrirë për çdo vend instalimi të dhënë në paragrafin (a) (7);

(5) një përmbledhje e strukturës të stafit të subjektit për çdo vend të specifikuar në paragrafin (a) (7); dhe

(6) një listë e tipeve të fasiliteteve që do të mbulohen nga licenca;

(7) një përmbledhje e aktiviteteve për çdo vend ku personeli shërben me qëllimin e vënies në punë ose mirëmbajtjes të fasiliteteve të përcaktura nga paragrafi (a) (8);

(8) një listë që siguron detaje operacionale të çdo fasiliteti, të lidhura me vendin e instalimit të pajisjes e përfshirë në paragrafin (a) (7);

(9) të detajojë programin e sigurisë të rrugëve ajrore, siç kërkohet nga paragrafi 2.3;

(10) të detajojë procedurat e subjektit të kërkuara nga:

(i) paragrafi 2.1 (b) (1) dhe (2) të lidhura me kompetencat e personelit;

(ii) paragrafi 2.2 (a) të lidhura me projektimin, instalimin dhe vënien në punë të fasiliteteve;

(iii) paragrafi 2.2 (b) të lidhur me operimin e përkohshëm të fasiliteteve për kontrollin e vendit të mundshëm të instalimit të fasilitetit;

(iv) paragrafi 2.4 të lidhur me kontrollin e dokumentacionit;

(v) paragrafi 2.5 të lidhura me inspektimet dhe testimet periodike të fasiliteteve;

(vii) paragrafi 2.7 të lidhur me kontrollin, kalibrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të inspektimit, testimit dhe matjes;

(viii) paragrafi 2.8 të lidhur me publikimin e informacioneve për fasilitetin;

(ix) paragrafi 2.9 të lidhur me kontrollet e fasilitetit mbas ndodhjes të ndonjë incidenti ose aksidenti;

(x) paragrafi 2.10 të lidhur me funksionimin difektoz të fasilitetit;

(xi) paragrafi 2.11 të lidhur me identifikimin, mbledhjen, indeksimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe fshirjen e rregjistrimeve;

(xii) paragrafi 2.12 të lidhur me kontrollin e brendshëm të cilësisë;

(11) procedurat e kontrollit, ndryshimit dhe shpërndarjes të ekspozimit.

(b) ekspozimi i aplikantit duhet të jetë i pranueshëm për DPAC-në.

Kapitulli III – Kërkesat Operacionale

3.1 Përmbushja e kërkesave në mënyrë të vazhdueshme

Çdo mbajtës licence të shërbimit të telekomunikacioneve duhet:

(1) të mbajë të paktën një kopje komplete të ekspozimit në vendet kryesore të specifikuara në

ekspozimin e tij;

(2) të përmbushë kërkesat e procedurave të detajuara në ekspozimin e tij;

(3) të vërë në dispozicion të personelit atë pjesë të ekspozimit të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e detyrave nga ana e tij;

(4) të vazhdojë të përmbushë standardet dhe kërkesat e kapitullit II të këtij udhëzimi të nevojshme për licencimin ;

(5) të njoftojë DPAC-në për çdo ndryshim të adresës, numrit të telefonit ose faksit, siç kërkohet nga formulari tip, brenda 28-ditesh nga ndodhja e ndryshimit.

3.2 Kodet e identifikimit dhe shenjat e thirrjes

Çdo mbajtës i një licence shërbimi telekomunikacionesh, që kërkon një kod identifikimi për një fasilitet radionavigimi ose një shenjë thirrje për një fasilitet komunikimi, duhet të aplikojë pranë DPAC-së, në përputhje me formularin tip.

3.3 Procedurat e komunikimit

Çdo mbajtës i një licence shërbimi telekomunikacionesh duhet të sigurojë që procedurat e tij për operimin e fasiliteteve të përfshira në listën e ekspozimit të tij, janë në përputhje me procedurat e aplikueshme të komunikimit të përshkruara në Aneksin 10, volumi II.

3.4 Instruksionet e operimit dhe mirëmbajtjes

Çdo mbajtës licence shërbimi telekomunikacionesh duhet të sigurojë, për përdorim dhe udhëzim të personelit të tij, instruksionet e operimit dhe mirëmbajtjes për çdo fasilitet të përfshirë në listën e ekspozimit të tij. Instruksionet duhet të kontrollohen sipas procedurave të kontrollit të dokumentacionit të kërkuara në paragrafin 2.4 dhe duhet të përcaktojnë kërkesat për operimin dhe mirëmbajtjen e çdo fasiliteti. Instruksionet duhet të përfshijnë një listë të:

(1) parametrave kritike,

(2) nivelet minimale të pranueshme të këtyre parametrave,

(3) pajisjet e testimit të kërkuara për matjen e këtyre parametrave,

(4) procedurat e detyrueshme të kontrollit për vënien në operim të fasilitetit,

(5) procedurat e detyrueshme të inspektimit dhe testimit për operimin dhe mirëmbajtjen e fasilitetit.

3.5 Shmangiet

(a) Mbajtësi i licencës të shërbimit të telekomunikacioneve mund të shmanget nga ndonjë nga kërkesat e këtij udhëzimi për të përballuar një situatë emergjente, nëse është e nevojshme të ndërmerret një veprim i menjëhershëm për mbrojtjen e jetës ose pronës të lidhura me transportin ajror.

(b) Një mbajtës licence, i cili shmanget për arsyet e dhëna në paragrafin a, duhet t'i dërgojë një raport me shkrim DPAC-së, sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 14 ditë pas emergjencës. Raporti duhet të permbledhë natyrën, masën dhe zgjatjen kohore të shmangies

3.6 Kufizimet mbi mbajtësin e licencës

(a) Mbajtësi i një licence shërbimi telekomunikacionesh nuk duhet të operojë një fasilitet (me përjashtim rastet për kontrollin e vendit të instalimit dhe në përputhje me procedurat e kërkuara në paragrafin 2.2 (b), nëse ka ndonjë arsye për të dyshuar për integritetin e informacionit të siguruar nga fasiliteti. Një arsye për të dyshuar për integritetin e informacionit të siguruar nga fasiliteti është çdo ndryshim në zonën kritike ku eshtë instaluar fasiliteti, derisa kontrollet e kryera të parametrave të fasilitetit verifikojnë që ndryshimi nuk prek dhe nuk do të prekë parametrat e fasilitetit.

(b) Mbajtësi i licencës nuk duhet të operojë një fasilitet radiotransmetues në brezin e frekuencave aeronautike, me përjashtim kur është në përputhje me një licencë aparati radio, të lëshuar për fasilitetin nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

(c) Me përjashtim ku një shmangie është kërkuar nga paragrafi 3.5 ose një testim i vendit të instalimit është kërkuar sipas procedurave të kërkuara nga paragrafi 2.2 (b), një mbajtës licence duhet të operojë një fasilitet vetëm nëse:

(1) fasiliteti është përfshirë në listën e ekspozimit të mbajtësit të licencës;

(2) parametrat e fasilitetit përmbushin informacionin e publikuar;

(3) parametrat e fasilitetit përmbushin kërkesat e aplikueshme të fasilitetit në paragrafin 2.2 (a);

(4) çdo sistem monitorimi i integritetit të fasilitetit është plotësisht funksional;

(5) të gjitha testimet periodike për fasilitetin janë kompletuar në përputhje me programet e parashikuar në paragrafin 2.5 (c) (2) dhe (3);

(6) fasiliteti është përfshirë në programin e sigurisë të rrugës ajrore, nëse shkatërimi, dëmtimi, ose interferenca në fasilitet mund të cenojë sigurinë e avionit në fluturim.

3.7 Ndryshimet në subjektin e mbajtësit të licencës

(a) Çdo mbajtës licence shërbimi telekomunikacionesh duhet të sigurojë që ekspozimi i tij është modifikuar dhe është në përputhje me situatën reale të subjektit lidhur me organizimin dhe fasilitetet.

(b) Mbajtësi i licencës duhet të sigurojë që çdo ndryshim i bërë në ekspozimin e mbajtësit të licencës përmbush kërkesat e aplikueshme në këtij udhëzimi dhe është në përputhje me procedurat e ndryshimeve të përfshira në ekspozimin e mbajtësit të licencës.

(c) Mbajtësi i licencës duhet t'i dorëzojë DPAC-së një kopje të çdo amendamenti të ekspozimit të tij sa më shpejt të jetë e mundur mbas përfshirjes të saj në ekspozim.

(d) Atje ku mbajtësi i licencës propozon të bëjë ndryshime në ndonjë nga pikat e mëposhtme, njoftimi paraprak dhe miratimi nga DPAC kërkohet:

(1) Drejtori Ekzekutiv;

(2) drejtuesit kryesorë, të përfshirë në listën e ekspozimit;

(3) Programi i sigurisë të rrugëve ajrore;

(4) Tipet e fasiliteteve që mbajtësi ka në operim.

(e) DPAC-ja mund të përshkruajë kushtet nën të cilat një mbajtës licence mund të operojë gjatë ose në vijim të ndonjë nga ndryshimet të specifikuar në paragrafin (d).

(f) Mbajtësi i licencës duhet të përmbushë kërkesat e përshkruara në paragrafin (e).

(g) Atje ku ndonjë ndryshim që referohet në këtë rregull kërkon një ndryshim në licencë, mbajtësi i licencës duhet ta dërgojë pranë DPAC sa më shpejt të jetë e mundur.

(h) Mbajtësi i licencës duhet të bëjë ndryshime të tilla në ekspozimin e tij, nëse DPAC-ja e konsideron të nevojshme në interes të sigurisë në aviacion.

3.8 Inspektimet dhe oditimet e sigurisë

(a) DPAC-ja mundet me shkrim të kërkojë që mbajtësit të licencës të telekomunikacioneve t'i bëhet ose të bëjë inspektim ose oditim të fasiliteteve, dokumenteve, dhe rregjistrimeve nëse DPAC-ja e konsideron të nevojshme në interes të sigurisë në aviacionin civil.

(b) DPAC-ja mund t'i kërkojë mbajtësit të licencës të japë informacione që i konsideron të nevojshme për inspektimin ose oditimin.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
Viktor Doda